

04.12.2007

I nderuari Z. HAMITI,  
Të nderuar anëtarë të bordit të ZRrE,

Ju lutem gjeni të bashkëngjitur versionin e kompletuar të modelit tuaj të të dhënave për KOSTT, ERO-ETR2 Template-19Oct07. Vetë të dhënat nuk janë të mjaftueshme për të përcaktuar të hyrat e lejuara dhe me atë tarifën, prandaj ne dëshirojmë që ti ngrisim disa çështje në lidhje me rezultatet e pritura në vitin 2007 dhe kërkesat për të hyra në vitin 2008. Ne dëshirojmë që ti diskutojmë me ZRrE-në këto pika.

### 1. Shpenzimet e mirëmbajtjes

Për periudhën Janar Shtator 2007, nga plani i mirëmbajtjes janë realizuar:

Mirëmbajtja në vlerë:	646.604
Mjete themelore nga të hyrat operative	<u>314,398</u>
<b>Gjithësejt :</b>	<b>961,002</b>

Shkaqet e një ngecjeje të tillë në realizimin e mirëmbajtjes, janë:

- aprovimi me vonesë i tarifave: faturimi sipas tarifave të aprovuara ka filluar për muajin maj, ndërsa inkasimi i parë është bërë në muajin korrik. Kjo ka rezultuar që paraqitja e inkasimit të parave të gatshme të ngarkohet në pjesën tjetër të vitit në krahasim me vlerësimet tona
- si pasojë e aprovimit të vonuar të tarifave, është shkaktuar vonesë në aprovimin e buxhetit dhe planit të prokurimit
- procedurat e zgjatura të prokurimit
- shumica e ofertuesve nuk kanë pasur mundësi që të liferojnë paisjet më së paku dy muaj pas nënshkrimit të kontratave.

Pritjet e KOSTT-it janë që në tremujorin e fundit të vitit 2007, shpenzimet e mirëmbajtjes të jenë € 926.929. Kjo do të bëjë që shpenzimet në përgjithësi të vitit 2007 të jenë € 1,887,931.

Vlera e kontratave të nënshkruara (të pa realizuara deri më tani) është € 1,297,039, si dhe vlera e kontratave të pa nënshkruara deri në fund të vitit 2007 është € 1,535,685.

Prandaj, shpenzimet në planin e mirëmbajtjes për vitin 2007 ka mundësi që të realizohen pothuajse plotësisht, ndonëse implementimi do të vazhdoj në vitin 2008.

Mirëmbajtja është e një rëndësie të jashtëzakonshme në përmirësimin e besueshmërisë dhe kapacitetit të sistemit elektroenergjetik të Kosovës, si dhe është vendimtare që të lejohen të hyra të mjaftueshme për të zgjeruar programin e mirëmbajtjes.

## 2. Shpenzimet e stafit

ZRRrE ka lejuar të hyrat për KOSTT-in në shumën prej 13,190 m Euro për vitin 2007. Në këto të hyra, në emër të shpenzimeve të stafit janë lejuar 1,460 mEuro, që paraqet 11.7% të të hyrave të lejuara. Këto të hyra janë planifikuar për 215 punëtorë.

Për vitin 2008, shpenzimet e lejuara të stafit janë € 1,757 m, nga të hyrat e përgjithshme të lejuara prej € 16,894 m. Këto të hyra janë planifikuar për 230 punëtorë.

Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it në takimin e mbajtur me 1 tetor 2007, ka aprovuar nivele të reja të pagesave duke i rregulluar pagesat bazë të punëtorëve si dhe pagesat për shujta në pajtim me ecuritë e çmimeve dhe rritjen e shpenzimeve të jetesës.

Kur janë vendosur të hyrat e lejuara për KOSTT-in për periudhën trevjeçare (2007-2009), nuk janë paraparë disa kategori të shpenzimeve të cilat bëjnë pjesë në shpenzimet e stafit, e të cilat punëtorëve u garantohen me Rregulloren e punës. Këto përfshijnë pagesat për pushime, përvojën e punës dhe pensione.

**Duke u bazuar në çështjet e lartpërmendura, kërkojmë rritjen e të hyrave të lejuara për shpenzimet e stafit për € 300.000 për vitin 2008. dhe 2009.**

## 3. Humbjet në transmision

Për përcaktimin e të hyrave të lejuara për 2007-09 nga ZRRrE-ja, në rishiqimin fillestar të tarifave në vitin 2006, është bërë supozimi se humbjet mesatare në rrjetin e transmisionit do të jenë rreth 3% për energjinë që hyn në sistemin e transmisionit për furnizim të konsumatorëve kosovar si dhe 1% për humbjet e transitit.

Modelimi më i detajuar si dhe barazimi i vëllimit aktual sugjerojnë shifra më të larta për vitin 2007 dhe KOSTT pret që rasti i njëjtë do të jetë edhe për vitet 2008 dhe 2009. Ky dallim është i rëndësishëm dhe thelbësor për KOSTT-in dhe është pritje e jona se nëse shkalla e humbjeve në transmision mbetet në nivelin aktual, pa përshtatje të të hyrave, kjo do të ndikojë seriozisht në

aftësinë tonë për të investuar tutje në sistemin e transmisionit. KOSTT ka bërë një paraqitje të veçantë për Humbjet në Transmision pasi që arsyet për këto devijime janë komplekse si dhe ndërlikohen me një numër të faktorëve si në vazhdim:

- Supozimet themelore kanë përcaktuar përqindjet fillestare të humbjeve;
- Kualiteti i përmirësuar i të dhënave që lejon matje më të sakta të rrjedhës së të dhënave;
- Teknika të përmirësuara të modelimit ku përdoren rrjedha më përfaqësuese të Mvar, rezistenca për largpërçuesit dhe kondensatorët si dhe lakoret e kohëzgjatjes së ngarkesës; dhe
- Vonesa në investime si pasojë e mungesës së fondeve.

Do të ishte i mirëseardhur një diskutim i detajuar për këtë temë si një çështje me urgjencë.

#### **4. Amortizimi dhe kostoja e kapitalit**

Në llogaritjen e të hyrave të lejuara nga ZRrE-ja , ekzistojnë dy sypozime kryesore lidhur me rishiqimin e parë të tarifave në vitin 2006, e që kanë të bëjnë me amortizimin dhe koston e kapitalit, të cilat kanë pasoja serioze për situatën financiare të KOSTT-it.

Situata aktuale është si vijon:

- Për asetet ekzistuese (nga 1 janari 2006) KOSTT-it nuk i lejohet të fitojë kthimin komercial apo amortizimin (ndonëse i lejohet që t'i mbulojë shpenzimet e mirëmbajtjes si dhe shpenzimet eventuale të financimit). Baza e Aseteve të Rregulluara (BAR) nga 1 Janari 2006, konsiderohet të jetë zero.
- BAR-it i janë shtuar edhe projektet e reja kapitale të aprovuara. KOSTT-i mund t'i rikthejë këto shpenzime përmes amortizimit dhe kthimit të lejuar në asete. Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (MPKK) e përdorur nga ZRrE-ja për përfitimin e kthimit të lejuar është 10.8% (reale).
- Projektet e reja të financuara nga donacionet janë përfshirë në BAR për qëllime të amortizimit, dhe me qëllim të llogaritje së kthimit, janë përfshirë proporcionalisht (për ta reflektuar diferencën në mes të shpenzimeve aktuale të financimit dhe MPKK-së).

Sa i përket asetëve ekzistuese, nuk ka ndonjë provision në të hyrat e lejuara për kthim apo për amortizim. Në pajtim me rregullat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në llogaritë financiare të KOSTT-it duhet të ketë amortizim. Megjithatë,

KOSTT-i nuk ka pasë financim direkt për këto asete, ndaj nuk ka të hyra të shtyera nga të cilat mund ta realizojë vlerën vjetore të amortizimit në pasqyrën e të hyrave. Si pasojë e kësaj, ulen përfitimet e raportuara dhe kjo e bën të vështirë, apo edhe të pamundur, ndonjë huazim komercial.

ZRrE-ja ka vlerësuar si reale MPKK-në prej 10.8%, ku komponenta reale e borxhit është 7.5-8.0%. Prapseprapë, kjo është nën shpenzimet reale të huamarrjes në Kosovë: KOSTT-i beson se kreditë nuk janë të arritshme për më pak se 12% (nominale) dhe atë për një kohë relativisht të shkurtër (jo më shumë se 5 vite). Prandaj, duhet pasë parasysh shpenzimet pasuese të rifinansimit për projektet afat-gjate të infrastrukturës.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës, në Raportin Vjetor të vitit 2006 ka publikuar normën e interesit prej 13.37 % si mesatare e produkteve të ndryshme dhe maturitetit, deri sa norma e interesit për biznese dhe korporata jo-financiare arrin në 14.32%.

ZRrE-ja ka sygjëruar që kreditë mund të sigurohen në tregun ndërkombëtar të kapitalit, por kjo është pa dyshim e pamundur për momentin (sidomos duke pasur parasysh krizat ndërkombëtare për kredi si dhe pasigurinë lidhur me statusin politik të Kosovës). Edhe në qoftë se ekziston mundësia për kredi nga tregjet ndërkombëtare, duke marrë parasysh mungesën e historisë në kredi dhe vlerën e përceptuar të ulët kreditore të KOSTT-it do të rezultoj në kosto më të lartë se sa ai i supozuar nga ZRrE.

Vlerësimet e ZRrE-së për MPKK-në poashtu supozojnë nivelin prej 60% të ingranimit (gearing). Është e vështirë që ky nivel të arrihet, qoftë edhe për një kohë të shkurtër. Ingranimi prej 35% do të ishte një supozim më real (por akoma sfidues)

Si rrjedhim, dalin në shesh këto probleme:

- (i) niveli i supozuar aktual i MPKK-së pengon huazimin komercial për shkak se komponenta rezultuese e të hyrave të lejuara nuk i siguron KOSTT-it të hyra të mjaftueshme për të paguar normën e kamatës në treg; dhe
- (ii) trajtimi aktual i asetëve ekzistuese nga aspekti rregullativ ulë përfitimet e raportuara dhe e shndërron KOSTT-in në një huamarrës joatraktiv.

Në këto rrethana, paraqiten dy kërkesa:

- a) të rritet vlera e MPKK-së, si dhe të rriten të hyrat e lejuara aqë sa do t'i mundësojnë KOSTT-it të paguaj normën e kamatës në treg; dhe
- b) të lejohet elementi i amortizimit për asetet ekzistuese

Një alternativë është që të pranohet fakti se të gjitha investimet kapitale në të ardhmen do të financohen nga BKK-ja apo donatorët ndërkombëtar.

Vlerësimet tona për MPKK-në në bazë të ingranimit real prej 35%, shpenzimi real i borxhit prej 9% apo 9.5% ( ekuivalente me 12% nominale-subjekt i inflacionit) si dhe kthimi i njejtë në kapital siç ka supozuar ZRrE-ja ( 10.8-12.8%) është 12.83% (real) si një vlerë mesatare.

MPKK-ja e propozuar prej 12.83 % do të kishte ndikim pozitiv në vlerësimin e ekspozimit të rrezikut që KOSTT mund të paraqes për institucionet financiare me marrjen e kredive komerciale.

Tërheqim vëmendjen se kreditë komerciale KOSTT-it i mundësohen vetëm për një afat të shkurtër. Prandaj, ekziston rreziku se rfinansimi pasues mund t'a ketë normën më të lartë të kamatës. Meqenëse ZRrE-ja shtyn KOSTT-in që të merr kredi komerciale, duhet ta pranojë zotimin për të lejuar të hyra të mjaftueshme në të ardhmen, në mënyrë që të mbulohen normat e larta të kamatës po qe se kjo është e domosdoshme.

Ne do të vlerësonim një takim me ju, për të diskutuar implikimet e këtyre çështjeve.

Sinqerisht,

Fadil Ismaili

Drejtor Menaxhues